



Tiranë më	protdate
Nr.	protnumber

## RELACION

### PËR

### VENDIMIN

### PËR

**PËR DELEGIMIN E KOMPETENCËS KOMISIONIT TË ZONËS SË**  
**ADMINISTRIMIT ZGJEDHOR NR. 88, BASHKIA HIMARË, PËR**  
**AKREDITIMIN E VËZHguesVE TË SUBJEKTEVE ZGJEDHORE PËR**  
**ZGJEDHJET E PJESHME PËR KRYETAR TË BASHKISË HIMARË TË**  
**DATËS 4 GUSHT 2024**

#### **I. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI**

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.

Referuar nenit 6, pika 1, 4 e 6, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 8, të vendimit nr. 23, datë 01.02.2023 të Komisionerit Shtetëror i Zgjedhjeve “Për procedurat dhe kriteret e akreditimit të vëzhguesve të subjekteve zgjedhore në KZAZ, KQV, VNV, në zgjedhje”, parashikohet se çdo subjekt zgjedhor ka të drejtë të caktojë nga një vëzhgues në KZAZ, në KQV dhe për çdo tavolinë në Vendin e Numërimit të Votave pas regjistrimit të kandidatit/kandidatëve për zonën zgjedhore përkatëse ose pasi ka paraqitur listë shumemërore. Akreditimi i vëzhguesve pranë komisioneve zgjedhore bëhet mbi bazën e të dhënave vetjake të çdo vëzhguesi. KQZ-ja ka të drejtë, me udhëzim të veçantë, t’u delegojë KZAZ-ve kompetencën e akreditimit të vëzhguesve, sipas pikës 1 të këtij neni.

Duke vlerësuar nga pikëpamja e objektit që trajton ky projektvendim, vlerësohet nga ana e ligjshmërisë së është në kompetencë të Komisionerit për ta shqyrtuar.

#### **II. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT**

Vendimi nr. 23, datë 1.2.2023 i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve përcakton procedurat dhe kriteret për akreditimin e vëzhguesve të subjekteve zgjedhore në komisionet e zonave të administrimit zgjedhor, Komisionet e Qendrave të Votimit dhe Vendet e Numërimit të Votave.

Ky vendim parashikon që Komisioneri i delegon KZAZ-së (Komisionet e Zonave të Administrimit Zgjedhor) kompetencën për të akredituar vëzhguesit e subjekteve zgjedhore.

Delegimi synon të rrisë efikasitetin e procesit zgjedhor duke e bërë më të shpejtë dhe më të qartë procesin e akreditimit.

Delegimi i kompetencave të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) tek Komisionet e Zonave të Administrimit Zgjedhor (KZAZ) është një praktikë që synon të përmirësojë menaxhimin e procesit zgjedhor. Kjo praktikë ka qenë një pjesë e rëndësishme e përvojës së deritanishme të KQZ-së.

Delegimi i kompetencave tek KZAZ-të ndihmon në përshpejtimin e procesit të akreditimit të vëzhguesve dhe vendimmarrjes së lidhur me zgjedhjet. Kjo redukton ngarkesën administrative të KQZ-së dhe lejon një menaxhim më të shpejtë dhe efektiv në nivel lokal.

KZAZ-të janë më afër terrenit dhe mund të përgjigjen më shpejt ndaj situatave të emergjencave dhe nevojave të papritura që mund të dalin gjatë procesit zgjedhor.

Duke deleguar kompetencat, KZAZ-të kanë mundësinë të marrin vendime të pavarura dhe të përshtatura për specifikat e zonave të tyre. Kjo rrit autonominë e kësaj trupe dhe ndikon në mirë administrimin efektiv të procesit zgjedhore.

Delegimi i kompetencave nga KQZ-ja tek KZAZ-të është një praktikë e konsoliduar. Ky proces ndihmon në rritjen e efikasitetit, shpejtësisë, transparencës dhe besueshmërisë së zgjedhjeve, duke përmirësuar menaxhimin e burimeve lokale dhe duke rritur autonominë dhe përgjegjësinë e KZAZ-se.

Për sa me sipër ne projektvendim parashikohet që KQZ-ja i delegon kompetencat KZAZ-së nr. 88, për akreditimin e vëzhgues subjekteve zgjedhore për KZAZ/KQV/GNV, sipas afateve të parashikuara në pikën 12, të vendimit nr. 3, datë 17.07.2024 të Kolegjit Zgjedhor.

<b>Erion Meta</b>	- Drejtorja e Administratës Zgjedhore
<b>Madalena KOJA</b>	- Drejtorja e Ligjshmërisë
<b>Majlinda ÇELMETA</b>	- Sekretari i Përgjithshëm (në mungesë dhe me autorizim)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE  
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Tiranë më	protdate
Nr.	protnumber

Data: DD MM VVVV

Nr: 000-000

Ora: HH:MM

V E N D I M

P Ë R

**DELEGIMIN E KOMPETENCËS KOMISIONIT TË ZONËS SË ADMINISTRIMIT  
ZGJEDHOR NR. 88, BASHKIA HIMARË, PËR AKREDITIMIN E VËZHguesVE TË  
SUBJEKTEVE ZGJEDHORE, PËR ZGJEDHJET E PJESSHME PËR KRYETAR TË  
BASHKISË HIMARË, TË DATËS 4 GUSHT 2024**

Në mbështetje të nenit 6, pikat 1, 4 e 6 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 8, të vendimit nr. 23, datë 01.02.2023 Komisionerit Shtetëror i Zgjedhjeve “Për procedurat dhe kriteret e akreditimit të vëzhguesve të subjekteve zgjedhore në KZAZ, KQV, VNV, në zgjedhje”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve;

V E N D O S:

1. T’i delegojë Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor nr. 88, Bashkia Himarë, kompetencën për të akredituar vëzhguesit e subjekteve zgjedhore për KZAZ, KQV, VNV, për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë, të datës 4 Gusht 2024.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

**Ilirjan CELIBASHI**

Data: dd mm vvvv Nr: .....  
Ora: hh:mm



Për delegimin e kompetencës Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor nr. 88, Bashkia Himarë, për akreditimin e vëzhguesve të subjekteve zgjedhore, për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë, të datës 4 gusht 2024